

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	05.10.2021	Kërkesë për informacion	12.10.2021	<p>Lidhur me pyetjen e parë: Me Urdhërin Nr. 349, datë 14.12.2020 "Për delegim kompetence" të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë DPSHTRR i delegohet kompetenca për përfaqësimin dhe kryerjen e veprimeve proceduale dhe administrative lidhur me procedurën e dorëzimit në përfundim të kontratës koncesionare. Marrja në dorëzim të ambienteve ka përfunduar më datë 31.12.2020.</p> <p>Në zbatim të këtij urdhëri nga ana jonë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për marrjen në dorëzim të ambienteve, pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike si dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse konform kontratës.</p> <p>Lidhur me pyetjen e dytë: Një pjesë e godinave të qendrave të kontrollit teknik në drejtoritë rajonale janë gjendur në kushte normale funksionale dhe një pjesë prej tyre ishin të pa përmirësuara, me lagështirë, jo të mirëmbajtura dhe të amortizuara dhe është parë e nevojshme për kryerjen e ndërhyrjeve nga DPSHTRR për transformimin infrastrukturor dhe krijimin e kushteve funksionale dhe cilësore për rikthimin në standartet bashkëkohore të këtij shërbimi.</p> <p>Për pjesën tjetër të pyetjeve DPSHTRR nuk disponon informacion, propozojmë të drejtoheni Njësisë së Zbatimit të Projektit Koncesionar pranë MIE si struktura kompetente e ndjekjes së realizimit të kontratës. Bashkëlidhur gjeni shkresën Nr.21862/8 Prot, datë 09.07.2021 "Informacion në lidhje me marrjen në dorëzim të mjediseve të koncesionarit dhe infrastrukturës" të DPSHTRR, e cila mbetet në vlerësimin tuaj nëse duhet bërë publike.</p>	E plotë	0
2	12.10.2021	Kërkesë për informacion	12.10.2021	<p>Në përgjigje të e-mailit Tuaj, në zbatim të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ju bëjmë me dije se ju nuk keni bashkëlidhur asnjë dokumentacion ligjor që provon lidhjen Tuaj me kërkesën tuaj në mënyrë që të merrni informacionin e kërkuar.</p> <p>Lutemi bashkëlidhni dokumentat përkatës për të marrë informacionin e kërkuar.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	0
3	12.10.2021	Kërkesë për informacion	12.10.2021	<p>Në përgjigje të e-mailit Tuaj, në zbatim të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ju bëjmë me dije se ju nuk keni bashkëlidhur asnjë dokumentacion ligjor që provon lidhjen Tuaj me kërkesën tuaj në mënyrë që të merrni informacionin e kërkuar.</p> <p>Lutemi bashkëlidhni dokumentat përkatës për të marrë informacionin e kërkuar.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	0
4	15.10.2021	Kërkesë për informacion	19.01.2021	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rugor ju bën me dije se:</p> <p>1- Leje Drejtimit Shqiptare të lëshuara para datës 23.01.2017, në hapsirën vendlindja kanë të shënuar qytetin e lindjes;</p> <p>2- Leje Drejtimit Shqiptare të lëshuara mbas datës 23.01.2017 në hapsirën vendlindja kanë të shënuar shtetë-lindjen (ALB për ALBANIA)</p> <p>Në marrëveshjen e konvertimit, është specifikuar çdo detaj i kartonit të Leje Drejtimit si rrjedhim, palet kontraktuese që kryejnë konvertimin e lejeve të drejtimit reciproke janë informuar në detaje për mënyren e plotësimit të kartonit të Leje Drejtimit, sigurisht edhe për këtë specifik lidhur me mënyrën e shënimit të vendlindjes.</p> <p>Faleminderit,</p>	E plotë	0
5	08.11.2021	Kërkesë për informacion - Unë jamë me pashaportizim në Mat dhe dosjen e automejtit e kamë në Peshkopi. A kamë të drejtë unë që ta tërheq dosjen në Tiranë ?	09.11.2021	<p>Për të bërë transferimin e dosjes së mjetit në Tiranë, ju duhet fillimisht të bëni ndërrimin e vendbanimit pranë Gjendjes Civile, pasi të dhënat merren automatikisht nga sistemi i Gjendjes Civile.</p> <p>Per me shume informacion rreth shërbimeve tona: <a href="https://www.dpshttr.al/">https://www.dpshttr.al/</a></p>	E plotë	0
6	15.11.2021	Kërkesë për informacion - Si mund të procedojmë me Ndryshimin Konstruktiv?	16.11.2021	<p>Procesi i ndryshimit konstruktiv: <a href="https://www.dpshttr.al/mjete/vetedeklaro-kerkesen-te-kryer-nje-ndryshim-konstruktiv-ne-mjet">https://www.dpshttr.al/mjete/vetedeklaro-kerkesen-te-kryer-nje-ndryshim-konstruktiv-ne-mjet</a></p>	E plotë	0

7	09.11.2011	Kërkesë për informacion- Si mund të bëj egjistrimin e mjeteve bujqësore të ardhura nga jashtë?	20.11.2011	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email nëpërmjet ADISES, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", për kërkesën e bërë ju bëjmë me dije se:</p> <p>Makinat bujqësore janë mjete rrugore me rrota ose me zinxhirë që përdoren në bujqësi ose në pylltari. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë njëloj si mjetet e tjera për të kaluar nga një vend pune te një tjetër, ose për të transportuar mallra bujqësore etj.</p> <p>Makinat bujqësore mund të jenë vetëlëvizëse (traktorë bujqësorë, autokombajnë, korreë bari) ose të tërhequra (rimorkio bujqësore, makinë mbledhëse gruri).</p> <p>Traktorët bujqësorë (me goma ose me zinxhirë), makinat bujqësore vetëlëvizëse me të paktën 2 akse (p.sh autokombajna) dhe rimorkiot bujqësore me peshë maksimale të autorizuar mbi 1.5 tonë duhet të regjistrohen pranë DRSHTRR-së dhe pajisen me leje qarkullimi, certifikatë pronësie dhe një targë që vendoset në pjesën e pasme. Pjesa e fundit e kompleksit të makinave bujqësore mban kopjen e targës së makinës bujqësore tërheqëse, shkronjat dhe numrat e së cilës janë me ngjyrë të kuqe.</p> <p>Procedurat për regjistrimin e këtyre makinave bujqësore:</p> <p>Të paraqiten me mjetin tuaj në Drejtorinë Rajonale ku keni vendbanimin.</p> <p>Dokumentet që duhet të keni me vete:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mjet identifikimi.</li> </ol> <p>Kur kërkuesi për regjistrimin e mjetit është subjekt fizik ose juridik nevojitet ekstrakti i QKB-së. Për personin që kryen veprimet duhet të ketë me vete autorizim dhe një mjet identifikimi;</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>3. Dokumentet shoqërues me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti, si: leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose çregjistrim për eksport, në origjinal;</li> <li>4. Dokumenti i zhdoganimit (DAV) të lëshuar nga Dogana Shqiptare, në origjinal;</li> <li>5. Certifikata e pronësisë, e vlefshme;</li> <li>6. Kontrata e sigurimit të mjetit.</li> </ol> <p>Nëse mjeti është blerë në Shqipëri:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>7. RBS - konfirmimi nga Regjistri i Barrëve Siguruese të cilin e siguron pas hartimit të kontratës së shitblerjes së mjetit pranë zyrrave tona të shërbimit ose te noteri.</li> </ol> <p>Shënim: Të gjithë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara. Nëse personi që paraqitet në sportel nuk është pronar i mjetit, veç dokumenteve të mësipërme duhet të ketë me vete edhe prokurën e posaçme/autorizimin për kryerjen e veprimeve në emër të pronarit të mjetit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Të kryeni Kontrollin Fizik të mjetit te Drejtoria Rajonale ku do të pajiseni me Certifikatën e Kontrollit Fizik.</li> <li>3. Paraqitje me të gjithë dokumentet e mësipërme në sportelet e regjistrimit të mjetit për të përfunduar të gjithë procedurën.</li> </ol> <p>Targat e makinave bujqësore janë të formës AA MB 00, me sfond jeshil, ndërsa shkronjat dhe numrat janë me ngjyrë të bardhë. Targat e rimorkiove bujqësore janë të formës AA RB 00, me sfond jeshil, ndërsa shkronjat dhe numrat janë me ngjyrë të bardhë.</p> <p>Tarifa:</p> <p>Kontrolli Fizik-1,500 lekë  Certifikata e pronësisë-2,000 lekë  Leja e Qarkullimit-1,000 lekë  Targa: 1,500 lekë.</p> <p>Faleminderit,</p>	0
---	------------	--	------------	---	---

8	03.12.2021	Kërkesë për Informacion	06.12.2021	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor - DPSHTRR në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bëjmë me dije se: Refeurar Mandat Paguesë bashkëngjitur nga ju, vërteton që pagesa është kryer pranë sportelit të bankës CREDINS për llogari të DPSHTRR.</p> <p>Për shkak se nuk keni marr faturën pranë zyrave të takses ku do të gjenerohej nga sistemi informatik edpshttr, si dhe pagesa është kryer gabimisht nga ju në llogari të DPSHTRR, dhe jo në llogari të Drejtorisë Rajonale Tirane. Pagesa e bërë nga ju, nuk është lidhur me këtë sistem dhe si rrjedhojë mjeti me targe AA756HZ nuk figuronte me taksa të paguara.</p> <p>Për sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, për çdo ditë vonesë për pagesën e takses vjetore të mjeteve të përdorura do të ketë rritje të vlerës së kamatvonesës me 0.06%. Në qoftë se pagesa do të kryhej nëpërmjet portalit qeveritar e-albania, do të shfaqej menjëherë në sistemin informatik edpshttr, duke u përfunduar si shërbim.</p> <p>Lutemi, që për çdo pagesë që do të kryeni në vazhdimësi të paraqiteni pranë zyrave të taksave për tu pajisur më parë me faturë.</p> <p>Për më shumë rreth DPSHTRR: <a href="https://www.dpshttr.al/">https://www.dpshttr.al/</a></p>		0
9	03.12.2021	Kërkesë për informacion	10.12.2021	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bënë me dije se;</p> <p>- Me shkresën tonë Nr. 20936/1, datë 25.10.2021 "Kthim përgjigje", Ju kemi informuar se mjetet me timon në krah të djathtë që janë regjistruar, pranë zyrave të DRSHTRR-së, deri në datë 21 Mars 2015, aktualisht, kanë të drejtë të karrullojnë.</p> <p>Ky informacion është në bazë të ligjit Nr. 175/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", ku në nenin 31 "Dispozita kalimtare", pika 2 thuhet "Pika 2 e nenit 9 hyn në fuqi 2 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji". Pika 2 e nenit 9 ka këtë përmbajtje "Ndalohet të regjistrohen mjetet me motor me timon në krah të djathtë, me përjashtim të rasteve të treguara në nenin 77, pika 2, të Kodit Rrugor".</p> <p>Ligji nr. 175/2014 ka hyrë në fuqi më datë 21.01.2015, ndërsa ndryshimet e nenit 76, pika 2, kanë hyrë në fuqi, 2 muaj mw vonw, më 21.03.2015;</p> <p>- Në lidhje me shkresat për vepruar DRSHTRR-të, në lidhje me mos regjistrimin e mjeteve me timon në krah të djathtë, Ju sqarojmë se procedurat për regjistrimin e mjeteve janë në bazë të akteve ligjore, të cilat i sqaruum më lart.</p> <p>- Lidhur me njoftimet për Policinë e Shtetit, Ju vëmë në dije se nuk është detyrim njoftimi nga ana e DPSHTRR-së, sepse ligji është i zbatueshëm për të gjithë. Midis DPSHTRR-së dhe DPPSH-së, ka komunikim të dhënash.</p> <p>Për më shumë informacion mbi këtë dhe të tjera: <a href="http://www.dpshttr.al">www.dpshttr.al</a></p>	E plotë	0
10	06.12.2021	Informacion - Leje drejtimi	06.12.2021	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor - DPSHTRR në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bën me dije se, Z. Hatellari mund të paraqitet për të rinovuar Lejen e Drejtimit në çdo kohë.</p> <p>Dokumentacioni i nevojshëm</p> <p>Për të rinovuar lejen e drejtimit, personi i interesuar paraqitet pranë DRSHTRR-së ku ka vendbanimin me këto dokumente me vete:</p> <p>Mjet identifikimi;</p> <p>Certifikatë mjekësore me fotografi, që vërteton afësinë shëndetësore për të drejtuar mjetin rrugor;</p> <p>Lejen e drejtimit aktual që zotëron.</p> <p>Kini parasysh*</p> <p>Nëse lejen e drejtimit do ta tërheqë një person tjetër, qytetari plotëson gjatë aplikimit një deklaratë ku autorizon tërheqjen e lejes së tij nga një person tjetër.</p> <p>Leja e drejtimit tërhiqet pranë sporteleve të shërbimit të Drejtorisë Rajonale ku është bërë aplikimi. Në Tiranë, leja e drejtimit tërhiqet në zyrat e shërbimit të ish-NSHRAK.</p> <p>Në Tiranë (zyrat e shërbimit në ish-NSHRAK), leja e drejtimit tërhiqet brenda 30 minutash. Në drejtoritë e tjera kjo procedurë mund të zgjasë 3-5 ditë pune.</p> <p>Për më shumë inormacion: <a href="https://www.dpshttr.al/leje-drejtimi/rinovim-i-lejes-se-drejtimit">https://www.dpshttr.al/leje-drejtimi/rinovim-i-lejes-se-drejtimit</a></p>	E plotë	0
11	10.12.2021	Kërkesë për informacion	10.12.2021	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bën me dije se; Ne bazë të Udhëzimit 682/4. Dt.01.04.2016 për aktivitetin e autoshkollave. Neni 16, pika 6,7,8 kategoria D i përfshin kategorit B dhe C pasi D-ja si një kategori më e lartë.</p>	E plotë	0